



18-12-2023

02/370/03-1473

	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b>  <b>Komuna e Vitisë</b> <b>Opstina Vitina-Municipality of Vitina</b>	
<b>ZYRA E PROKURIMIT</b>		

## KONTRATË PËR SHËRBIME

Nr. i Prokurimit <sup>1</sup>	657-23-11621-2-1
Nr. i brendshëm	VI657-23-062-221

**TITULLI I KONTRATËS:** *Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit*

### E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
<b>Rizah Avdiu B.I., Viti, 61000, Viti, Kosovë</b>	<b>Komuna e Vitisë</b>
Përfaqësuar nga	Përfaqësuar nga:
Rizah Avdiu, drejtor	Fadil ABAZI, zyrtar përgjegjës i prokurimit
  v.v	  v.v

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**PJESA I E KONTRATËS:**

**KONTRATA**

**Komuna e Vitisë**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

**Rizah Avdiu B.l., Viti, 61000, Viti, Kosovë**, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë: **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit** me numër prokurimit: **VI657-23-11621-2-2-1**

**Neni 1: Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është **performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjë prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues; i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ofruesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

**Neni 2: Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve **18,700.00 €**

Me shkronja: **Tetëmbëdhjetë mijë e shtatë qind Euro**

**Kontrata hynë në fuqi me 14.12.2023 dhe përfundon në datën 14.06.2024**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Kontrata ka objekt të transportit për një nxënës, por në rast të paraqitjes së nevojës edhe për një tjetër nxënës, në kushte të njëjta dhe me çmim të njëjtë, kjo kontratë mund të rritet edhe për çmimin e njëjtë mujor.

2.4 Kjo kontratë në kushte të pandryshueshme çmimi, sasi dhe vlere, nëse dakordohen dy palët kontraktuese, mund të vazhdohet edhe për një afat kohëzgjatje sa është kjo kontratë.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

**Neni 3: Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimit);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Ofruesin e Shërbimeve		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Rizah Avdiu	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	drejtor	Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.12.2023	Data:	15.12.2023
Vula:		Vula:	

## PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shioqcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tënderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rast, dhe "Palet" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPX" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim pa apurak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rast të kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bërë.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmerisë që zbatohen për dhënie të kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

Nr.b.prokurimit: V1657-23-11621-2-2-1;Nr.brendsheri: V1657-23-052-221- Deklarimi i qytetit per festat e fundvitit

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si për të ish-in akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aproximi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve, ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Ofruesit të Shërbimeve, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Ofruesi i Shërbimeve duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe e ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 11.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## **Neni 8 Forca madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zolit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të lillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës. Përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10           Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafët të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11           Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtimit paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.



16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e iajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhej për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17**

##### **Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18**                    **Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19**                    **Konsekuencat e Shkeljes së kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose

Nr.b.prokurimit: VI657-23-11621-2-2-1;Nr.brendshëm: VI657-23-062-221- Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezullojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

**Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

**PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentim et/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>Gjuha Shqipe</b>
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Që nga <b>dita e nënshkrimit, 14.12.2023</b> deri me <b>14.06.2024</b>
Pranimet	6.4	Menaxher i kontratës është <b>Agim Misini</b>

	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <b>Komuna e Vitise</b>
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> në ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është  1,870.00€
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:  a) Automjeti motorik i Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> b) Përgjegjësia e Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[shëno shumën]</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumën]</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesat do të bëhen pas pranimit të shërbimeve nga ana e menaxherit. Pagesat duhet të behen konform Ligjit për financa publike.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Sherbimet duhet të jene konform pershkrimit ne paramase, OE eshte pergjegjes per kualitetin e sherbimit. Porosia e shërbimit duhet të kërkohej 24 orë, para fillimit të aktivitetit. Komunikimi të behet me shkrim permes e-mailit
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<i>[Shëno ose]</i>  a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike</b> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>

## KOMUNA E VITISË

### DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

#### DEKORIMI I QYTETIT PER FUNDVIT

Nr.1	Dekorimi i qytetit për festat e fund-vitit,dekorimi behet nga data 04 deri më 08.12.2023	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e portave hyrëse me dimensione 3x3 sipas specifikacionit dhe të vendosen të sheshi Adem Jashari në Viti në dy anët,dhë mbishkrimi „Gëzuar 2024” <b>Vërejtje:</b> Shiriti i kuq dhe shiriti bardhë kurdel duhet të jetë i punuar me drita ngjyrë të kuqe dhe të bardha dhe të mbeshjtjellen komplet gypat e portave egizistuese me shirit dhe drita.Duhet të rrethohet me dekorime ndriques p.sh me elemente dekoruese.Furnizimi dhe montimi i kabllos si dhe lidhja me rrymë për ndriqim për dy portat egizistuese,nëri shirit vendoset ë hyrje të sheshit Adem Jashari dhe tjetëri vendoset te sheshi Nëna Terezë	copë	2	700	1400
2	Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e dritave dekorues në formë rrjetë për vendosje në hapësirën në mes 2 shtyllave në sheshin Adem Jashari sipas fotos ngjyrë të verdhë të ngrohtë. Vërejtje: Drita duhet të jetë e punuar me kablla prej gome me mbrojtje IP44. Duhet të jenë 20 rende nga 10m’	m’	150	4	600
3	Furnizimi dhe Montimi i dritave dekoruese ,në shtyllat e ndriçimit publik dhe drunjët nëpër qytet. Llogaria bëhet për copë.	copë	85	10.00	850
4	Furnizimi dhe Montimi i dritave dekoruese në sheshin Njazi Azemi në formë rrjete në drunjët ekzistues. Llogaria bëhet për copë.	copë	48	10.00	480

	Furnizimi dhe Montimi i dritave dekoruese në formë rrjete në drunjët ekzistues në qytet.				
5	Llogaria bëhet për copë.	Copë	220	10.00	2200
6	Fishekëzjarrë me 800 shpërthime	copë	1	300.00	300
7	Furnizimi dhe Montimi i dritave dekoruese në shshtyllat ekzistuese në forme rrethore në qytet, Rr Adem Jashari dhe sheshi Nëna Terezë, dhe një pjese e Lumit Morava	m <sup>2</sup>	3,700	0.95	3515
8	Dhurata për fundvit për kujdestarin (orë dore), zjarrfiksat, policia, shëndetësia	copë	60	10.00	600
9	Furnizimi me Material të nevojshëm për lidhjen e elementeve dekoruese siç janë kabllot të ndryshme, lidhese plastike, shiritat izolues etj. Llogaria bëhet paushall.	paushall	1	200.00	200
10	Furnizimi dhe Montimi i dritave dekoruese, nëpër shtyllat e ndriqimit publik në sheshin Njazi Azem Llogaria bëhet për copë.	copë	40	10.00	400
11	Ndriqim bëhet në formë rrjete led shirit ngjyra të ndryshme behet në shtylla të ndriqimit publik tërë sheshi në gjatësi prej 150m' dhe gjerësi 10m' horizontale dhe vertikale 1m' nga Sheshi Rr Adem Jashari, dhe sheshi Nëna Terezë	m <sup>2</sup>	5,200	0.95	4940
12	Litar për lidhjen e dritave dekoruese në shtyllat ekzistuese Ø04 mm	m <sup>2</sup>	4,300	0.05	215
13	Topa dekorues për vendosje në breq me dimensione min Ø 22cm - Ø 25cm me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë. Topat dekorues duhet të jenë ndriques me flash llambë me ngjyrë të bardhë të ngrohtë, sasia duhet jetë gjysma të kuqe dhe gjysma të verdha.	Copë	1	1,000.00	1000

	Furnizimi dhe montimi i bredhit metalik me dimensione :Lartesia 6m' me diameter 3m'.Në llogari hynë edhe punimi i rrjetes për mbeshjtjelljen e bredhit si dhe ndriqimi i bredhit me të gjitha instalimet (dritat dekoruese ne formë rrjete , si dhe stolisja me elemente te ndryshme dekoruese.	Copë	1	1,000.00	1000
14	Dhurata për fëmijë	copë	200	5	1000
<b>Totali</b>					<b>18,700.00 €</b>

*Të gjitha pozicionet, montimi i elementeve dekoruese, si dhe demontimi dhe paketimi i të gjitha elementeve dekoruese pas mbarimit të festave, në bashkëpunim me organin mbikqyrës duhet të kthehen në të njëjtën pozicion (shtyllat elektrike drunjët ) të cilat janë shfrytëzuar për vendosjen e elementeve dekoruese të projektit. Vendosija e elementeve dekoruese të cilat do të montohen caktohen nga organi mbikqyrës, dekorimi behet në rrugën, Rr. Adem Jashari të gjitha këto pozicione duhet të dekorohen në të dy anet e rrugëve, gjithmon në bashkëpunim nga organit mbykqyrës.*

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Rizah Avdiu B.I. ( D.P.H. BAR' ON )
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË	Rizah Avdiu
NËNSHKRIMI:	
DATA: 22.11.2023	22.11.2023
VULA:	

1. Dhaluz
2. Dhaluz
3. A. Jaluzi



# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 120950

Për **KOMUNA E VITIS**

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **Rizah Avdiu B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **DEKORIMI I QYTETIT PËR FESTAT E FUNDËVITIT**

Nr. prokurimit: 657-23-11621-2-2-1 , Nr. brendshëm: VI657-23-062-221

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t' i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,870.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **1,870.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 366 ditë kalendarike prej **14.12.2023** deri më **14.12.2024**

Data lëshimit: 14.12.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

Pranuar - Primitje Më/Dana 18-12-2023			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlora Vendbanes



02/370/01-1476  
**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republik of Kosovo**  
**Komuna e Vitisë**  
**Opština Vitina-Municipality of Vitina**



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01- 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

## V E N D I M

PËR MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHERBIMEVE SIPAS KONTRATËS: Dekorimi i qytetit pwr festat e fundvitit. Nr.Pr. 657-23-11621-2-2-1, Nr.Br. VI657-23-062-221

### I.

Agim Misinut, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratën Dekorimi i qytetit pwr festat e fundvitit. Nr.Pr. 657-23-11621-2-2-1, Nr.Br. VI657-23-062-221

Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës emërohet: **Basri Aliu**

### II.

Menaxheri nga neni I i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e shërbimeve të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar,
- Të siguroj kontroll të kostove, cilës së dhe sasisë dhe kohën e kryerjes së shërbimeve profesionale të mbikqyrjes
- Të siguroj arttijen e qëllimit të kontratës, fushëveprimit, specifikacionit dhe përgjegjësit e AK të cilat i ka detyrim shërbimkryesit, sipas kontratës
- Të dorëzoj Planin e menaxhimit të kontratës dhe mbikëqyr kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj ose përmbushjen dhe raporton tek mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë
- Të pranoj shërbimet dhe të percjell pagesat e kryera.

### III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, për detyrimet dhe përgjegjësit e menaxherit nga neni I i këtij vendimi

### IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit, Zyrës së Prokurimit,
2. Operatorit,
3. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË  
 Sokol Haliti

